



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE INF.SJP-A

Nr. 1172/1 prot.

Tiranë, më 07/10/2024

Lënda: *Informacion i Drejtorisë së menaxhimit të Burimeve Njerëzore për Konkursin Punonjës Administrative në:*

- *Rektorat; Sektori Sallave & Shërbimeve Tjera*
- *Specialist FONIE*

Rektorit të Universitetit të Arteve

Në vijim të procedurës së konkurrimit, për Specialist Fonie, në Rektoratin e UART, shpallur në Buletinit e Njoftimeve Publike nr. 63, datë 23/09/2024 dhe në Faqen zyrtare elektronike të Uart, pranë zyrës së Drejtorisë së Manaxhimit të Burimeve Njerëzore u paraqitën 3 (tre) dosje:

1. **BLERTI LECI** - mbaruar **UART FAKULTETI I MUZIKËS** ;
2. **ALTIN SULAJ** - mbaruar **UT FAK. SHKENCAVE SOCIALE**;
3. **LORENC DUSHI** - mbaruar **UT FAK. GJUHËVE TË HUAJA**.

Ju faleminderit,

Msc. Elia **PLAKU/ADEMI**

Drejtoresh/Drejtore

Menaxhimi Burimeve Njerëzore





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE INF.SJP-A

Nr. 1172/2 prot.

Tiranë, më 07/10/2024

Lënda: *Informacion i Drejtorisë së menaxhimit të Burimeve Njerëzore për Konkursin Punonjës Administrative në:*

- *Rektorat; Sektori Sallave & Shërbimeve Tjera*
- *Specialist NDRIÇIMI*

Rektorit të Universitetit të Arteve

Në vijim të procedurës së konkurrimit, për Specialist Ndrichi, në Rektoratin e UART, shpallur në Buletin të Njoftimeve Publike nr. 63, datë 23/09/2024 dhe në Faqen zyrtare elektronike të Uart, pranë zyrës së Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore u paraqitën 2 (dy) dosje:

1. **DASHMIR FYSA** - mbaruar **UART FAKULTETI I MUZIKËS ;**
2. **ARLIND DEDA** - mbaruar **UART FAKULTETI ARTIT SKENIK.**

Ju faleminderit,

Msc. Elia PLAKU/DEMI

Drejtoresh/Drejtorie

Menaxhimi Burimeve Njerëzore





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

Nr. 1296/1 Prot.

Tiranë, më 09.10.2024

URDHËR

Nr. 37/1, Datë 09/10/2024

PËR

**NGRITJEN E KOMISIONEVE TEKNIKE AD HOC PËR KONKURSET E
PUNËSIMIT TË PERSONELIT ADMINISTRATIV, CAKTIMIN E DATËS DHE
ORËS SË KONKURSIT SI DHE MËNYRËS SË VLERËSIMIT**

Mbështetur në nenin 36, pika 12, në nenin 67, pika 3 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 27, pika 2, në nenin 71, pika 7 të Statutit të Universitetit të Arteve, në Urdhrin e Rektorit nr. 37, datë 07.10.2024 si dhe në shkresat e Fakultetit të Muzikës nr. 1296/1 prot., datë 07.10.2024 dhe të Fakultetit të Artit Skenik nr. 1296/2 prot., datë 08.10.2024, nëpërmjet së cilave përcillen propozimet për dy anëtarë të personelit akademik që do të jenë pjesë e komisioneve teknike të vlerësimit të kandidatëve konkurrent në konkurset e punësimit,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit teknik ad hoc për konkursin “Specialist fonie, Salla e Madhe e Koncerteve” me këtë përbërje:
 - a. Prof. Asoc. Dorian ÇENE
 - b. Prof. Endri SINA
 - c. Z. Enis MULLAJ

Konkursi do të zhvillohet ditën e enjte, datë 10 Tetor 2024, nga ora 9:00 deri më 12:00.

2. Ngritjen e komisionit teknik ad hoc për konkursin “Specialist ndriçimi, Salla e Madhe e Koncerteve”, me këtë përbërje:
 - a. Prof. Arian PAÇO
 - b. Prof. Miltiadh KUTALI
 - c. Prof. Asoc. Alert ÇELOALIAJ

Konkursi do të zhvillohet ditën e enjte, datë 10 Tetor 2024, nga ora 12:00 deri më 14:00.

3. Komisionet teknike sipas pikave 1 dhe 2 të këtij urdhri, specifikimet e kërkesave praktike t’i vendosi në varësi të funksionit dhe përdorimit të pajisjeve të fonisë dhe ndriçimit. Secili prej komisioneve, t’u kërkojë konkurrentëve realizimin e një etydi artistik. Vlerësimi maksimal është deri në 60 pikë.

4. Komisionet teknike sipas Urdhrit nr. 37, datë 07.10.2024 të Rektorit do të bëjnë intervistën e strukturuar me gojë dhe vlerësimi maksimal është deri në 25 pikë.
5. Komisioni administrativ, sipas Urdhrit nr. 37, datë 07.10.2024 të Rektorit, do të vlerësojë dosjen (jetëshkrimin dhe dokumentacionin bashkëlidhur) dhe do të bëjë vlerësimin deri në maksimalisht 15 pikë.
6. Ngarkohen për njoftimin dhe zbatimin e këtij urdhri Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore & I A-P si dhe anëtarët e komiseve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

Nr. 1296 Prot.

Tiranë, më 07.10.2024

URDHËR
Nr. 37, Datë 07/10/2024

PËR

**NGRITJEN E KOMISIONEVE AD HOC QË DO TË ANGAZHohen NË
KONKURSET E PUNËSIMIT TË PERSONELIT ADMINISTRATIV**

Mbështetur në nenin 36, pika 12, në nenin 67, pika 3 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 27, pika 2 si dhe në nenin 71, pika 7 të Statutit të Universitetit të Arteve,

VËREJ:

Rektorati i Universitetit të Arteve ka shpallur, në Buletinin e Njoftimeve Publike (BNJP nr. 63, datë 23.09.2024), konkursin për 2 (dy) vende të lira pune:

- Specialist fonie, Salla e Madhe e Koncerteve;
- Specialist ndriçimi, Salla e Madhe e Koncerteve.

Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në përfundim të afatit për aplikim, ka dërguar informacion mbi aplikantët, përmes shkresave nr. 1172/1 prot., datë 07.10.2024 si dhe 1172/2 prot., datë 07.10.2024. Në vijim të procedurës së punësimit dhe për efekt të vlerësimit e përmbylljes së konkursit, mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit teknik për konkursin "Specialist fonie, Salla e Madhe e Koncerteve" dhe të komisionit teknik për konkursin "Specialist ndriçimi, Salla e Madhe e Koncerteve".
2. Fakulteti i Muzikës të propozojë 2 (dy) anëtarë të personelit akademik për komisionin teknik të fonisë, ndërsa Fakulteti i Artit Skenik të propozojë 2 (dy) anëtarë të personelit akademik për komisionin teknik të ndriçimit.
3. Propozimet nga fakultetet të përcillen brenda ditës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.



4. Anëtar i tretë për secilin komision do të caktohet nga Rektori.
5. Ngritjen e komisionit administrativ, për organizimin e procesit të punës dhe mbështetjen e komisioneve teknike, me përbërje si më poshtë:
 - a. Adela Kusuri
 - b. Elia Plaku/Ademi
 - c. Redion Shehu
6. Komisioni sipas pikës 5 të këtij urdhri kryen veprimtari administrative dhe nuk ka të drejtë intervistimi apo vlerësimi të kandidatëve.
7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore & I A-P, Fakulteti i Muzikës dhe Fakulteti i Artit Skenik.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Erald BAKABE

